

*Tiranë, 22.07.2021***D O K U M E N T    D E B A T I****5 VJET NGA MIRATIMI I REFORMËS NË DREJTËSI:  
ARRITJE, PROBLEME DHE SFIDAT PRIORITARE**

---

Në korrik 2016 parlamenti miratoi reformën në drejtësi. Ishin 140 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim, - me mbështetje edhe nga deputetë që de facto ishin kritik ndaj reformës apo siç rezultoi, subjekte të dekriminalizimit dhe të hetimit nga drejtësia e reformuar. Reforma u mundësua nga investimi i jashtëzakonshëm i SHBA dhe BE, ajo krijoi institucionin e vettingut dhe ndryshoi së bashku me Kushtetutën edhe më shumë se 25 ligje organike ose të thjeshta. Koha tregoi se ndryshimet kushtetuese dhe ligjore ishin sa të nevojshme aq edhe të hartuara me nxitim dhe pa bazë të qëndrueshme referuese, duke sjellë ndërhyrje të tjera ligjore në së paku 15 ligje dhe në disa raste si Kodi Penal, në ndryshime 3-4 herë brenda 2-3 vitesh nga i njëjti parlament! Ndryshimet ligjore kushtetuese dhe ligjore ishin aq të shumta sa asnjë ligj nuk arriti të nxjerrë në kohë aktet nënligjore dhe se midis vetë ligjeve u gjetën nga GJK elementë antikushtetues.

Konsensusi i gjerë politik për reformën në drejtësi nuk mjaftoi për të jetësuar reformën në kohë: të gjitha institucionet e reja të drejtësisë, përfshirë organet e vettingut, KLP, KLGJ, KED, ILD, PP, SPAK, GJK, GJL, etj, u krijuan ose u zgjodhën jashtë afatit kushtetues dhe ligjor. Partitë dhe institucionet harxhuan një vit kohë për të miratuar në korrik 2017 organet e vettingut në drejtësi, KPK, KPA dhe IKP. Midis 2018-2020 Shqipëria mbeti pa Gjykatë Kushtetuese dhe Gjykatë të Lartë, midis 2017-2019 u zgjodh një Prokuror i Përgjithshëm i përkohshëm, ndërkohë që institucione si KLP mbetën për një kohë të gjatë pa anëtarë të plotë dhe SPAK u krijua pa numrin e parashikuar të prokurorëve.

Procesi i vettingut rezultoi shumë më kompleks sesa ishte menduar, rreth 58% e prokurorëve dhe gjyqtarëve humbën postet e tyre dhe u larguan nga sistemi. Gjatë 3-4 viteve të fundit, ecuria disproporcionale midis daljeve nga sistemi dhe hyrjeve në sistem krijoi hendek në burimet njerëzore duke krijuar efekt domino vakancash në të gjitha nivelet e gjyqësorit dhe të drejtësisë. Premtimi i qeverisë se Shqipëria ka kapacitete të mjaftueshme njerëzore rezultoi i gabuar dhe vuri në dilemë pritshmëritë e reformës. Nga ana tjetër, proceset e zgjedhjeve të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, u shoqëruan me numër të kufizuar kandidatësh cilësor, si dhe me devijim nga standardet e larta kushtetuese në numrin e

kandidatëve për vend vakant, në procedura, në lobime dhe në krijimin e precedentit të emërimeve pa vetting. Mbi 50 çështje janë në pritje për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese, mbi 30 mijë mbeten në pritje në Gjykatën e Lartë dhe 2-3 herë më shumë çështje janë në pritje në nivelet e tjera të gjykatave dhe në prokurori.

Nuk ka asnjë dilemë se pavarësisht kostove financiare, njerëzore dhe institucionale, reforma në drejtësi mbetet zhvillimi më pozitiv i dekadës së fundit në Shqipëri. Rezultatet e saj, ndonëse të vonuara dhe të pjesshme, janë arritjet e vetme të demokracisë funksionale e shtetit të së drejtës. Besimi publik tek SPAK është besimi më i lartë tek një institucion dhe vala e denoncimeve të vazhdueshme në SPAK apo në GJK është tregues i etjes, por edhe i besimit tek ndryshimi. Më 2021 Shqipëria ka Gjykatë Kushtetuese funksionale, Gjykatë të Lartë funksionale, ka Prokuror të Përgjithshëm të pranuar gjerësisht, ka SPAK me mbështetje maksimale, ka ILD funksional, ka KLGJ dhe KLP që po reflektojnë më shumë maturi sesa më parë, ka Shkollë të Magjistraturës funksionale dhe ka vetëdije qytetare për reformën, më realiste, më solide dhe më optimiste.

Nga ana tjetër, mesazhi thelbësor i reformës: koha për llogaridhënien, fund pandëshkueshmërisë dhe sistemit korporativ korruptiv, - vlen edhe për politikën, por konsensusi u arrit vetëm për reformën në drejtësi, jo për reformën dhe vettingun në politikë. Po ashtu, ndikimi politik, qoftë përmes përdorimit politik të reformës për qëllime elektorale, qoftë nga sistemi i promovimit klanor apo edhe përmes denigrimit me "gjyq publik" të çdo vendimmarrjeje të drejtësisë që cenon oligarkinë politike, mediatike dhe ekonomike, - janë tregues i qartë se politika në tërësi nuk e ka dashur, nuk e do dhe nuk mund ta duartrokasë reformën në drejtësi.

### ***Cilat do të jenë sfidat prioritare të reformës në drejtësi në 1-2 vitet e ardhshme?***

1. **Dhënia e drejtësisë?** Në 5 vite është folur pafund për reforma në drejtësi dhe institucione të reja, tanimë qytetarët presin të shohin drejtësi në gjykata dhe prokurori. Siç thuhej në ditët e para të reformës 5 vjet më parë, drejtësia e vonuar është drejtësi e mohuar. E njëjta sentencë vlen edhe tani pas 5 vitesh. Vendimmarrjet profesionale dhe transparente, respektimi i afateve ligjore të hetimit, gjykimit dhe vlerësimit, njësimi i standardeve në dhënien e drejtësisë, drejtësi edhe për qytetarin e braktisur dhe pa mundësi politike e financiare ndikimi, barazi përpara ligjit dhe përballje reale me dosjet VIP të oligarkisë politike dhe ekonomike, janë e mbeten sfida thelbësore e ditëve, javëve, muajve dhe viteve që vijnë. Po ashtu, Harta Gjyqësore nuk mund të jetë hartë krize për emërimet aktuale në drejtësi, por hartë e shanseve dhe të drejtave qytetare për drejtësi.
2. **Integriteti e drejtësisë?** Sistemi i ri nuk mund të lejohet të imitojë sistemin e vjetër dhe as të jetë vijues e produkt i tij. Një sistem korporativ korruptiv nuk mund të zëvendësohet nga një tjetër sistem i njëjtë. Rastet e hetimeve dhe arrestimeve 2020-2021 për gjyqtarë e

prokurorë apo rastet e solidaritetit korruptiv për mbrojtjen e promovimin brenda sistemit të figurave të njohura korruptive e abuzuese me të drejtën, - janë jo vetëm tregues se korrupsioni në drejtësi vijon të ketë ndikim të madh, por edhe dhe se mesazhi i reformës nuk ka shkuar ende tek ata që duhet të jenë realizuesit e saj. Largimi nga sistemi, sidomos në rastet e akuzave për korrupsion, duhet shoqëruar me hetime të burimeve financiare, masa ligjore deri në sekuestro dhe provë reale se premtimi për integritet dhe fund pandëshkueshmërisë do të respektohet.

3. **Legjitimiteti i drejtësisë?** Procesi i zgjedhjes, emërimit, promovimit periodik ose fillestar në organet e qeverisjes së drejtësisë dhe në vetë sistemin gjyqësor e Prokurori, meriton ndryshim të thellë cilësor, më shumë konkurrencë, më shumë cilësi kandidatësh, më shumë transparencë, më shumë meritokraci dhe më shumë llogaridhënie. Fiktiviteti në kandidime dhe klientelizmi në emërime e promovime mbeten kërcënim serioz. Kuvendi, qeveria dhe Presidenti nuk mund të kenë të njëjtat standarde preferenciale klienteliste e politike si përpara reformës ashtu edhe tani në jetësimin e saj: organet e drejtësisë duhet të kenë legjitimitet të plotë kushtetues, (me 100% anëtarë në GJK, GJL, KLP, KLP, KPA, etj), duhet të kenë sistem të verifikimeve periodike dhe duhet që çdo emërim/zgjedhje të bëhet në afatin ligjor dhe kushtetues.
4. **Kultura e drejtësisë?** Reforma nuk mund të ketë sukses afatgjatë nëse nuk ndikon dhe ndryshon kulturën institucionale, politike dhe qytetare ndaj konceptit të drejtësisë. Reforma nuk mund të përdoret si alibi, si plaçkë elektorale, si kërcënim apo si mjet për të pamundësuar drejtësinë fundore. Kultura krijohet edhe me akte simbolike, p.sh, duke marrë përgjegjësi individët dhe zyrtarët që rezultojnë nga GJK se kanë miratuar akte antikushtetuese, ata që provohen se kanë marrë vendime të gabuara edhe administrative me pasojë ligjore dhe financiare për shtetin të përballen me çmimin / kompensimin e pasojës, duke hetuar e gjykuar edhe ata që shantazhojnë kritikët e reformës dhe mbështetësit e saj, si dhe duke reformuar tërësisht sistemin universitar, sidomos programet mësimore të drejtësisë.
5. **Shumë institucione pak përgjegjësi?** Një nga rrishtë e reformës ishin krijimi i së paku 10 institucioneve, secili i pavarur në të drejta, përgjegjësi, organikë dhe buxhet, por kjo risi rrezikon të bëhet problemi i ri i reformës, pasi organet kolektive nuk mbajnë asnjëherë përgjegjësi dhe se shumë organe d.m.th, shpërndarje të përgjegjësive dhe alibi për çdo dështim. Reforma i mungon një strategji bashkëvepruese institucionale, një mekanizëm monitorimi realist institucional, një instrument i qartësimin të përgjegjësive dhe një adresë ku mund të adresohen të gjitha ato.
6. **Fundi i periudhës transit?** Në korrik 2022 përfundon mandati i organeve të vettingut, KPK, IKP, ONM. Sipas Kushtetutës dhe ligjeve, vettingu do të vijojë të bëhet nga organet

ekzekutuese, KLGJ e KLP, një detyrë që de facto ato as nuk kanë kapacitet ta bëjnë dhe as nuk mund ta bëjnë. Zgjidhja? Ka disa, përfshirë edhe skanimin e vettingut të deritanishëm, vendosja e prioritetëve në subjektet e vettingut (KPK trajtoi me prioritet disa dhjetëra raste të të rinjve magistratë dhe asistentë ligjore me përvojë minimale në sistem, ndërkohë që zhvendosi në kohë pa afat vettingun e gjyqtarëve e prokurorëve me rol thelbësor e jetëgjatësi shumëvjeçare në sistem!), si dhe reformimit të sistemit të vlerësimit nga ILDKPKI, DSK, etj, organe të cilat dështuan të ofrojnë informacione të standardeve të njëjta për subjektet e deritanishme të vettingut. Idetë që më 2022 të ndryshohet kushtetuta për shtimin e mandatit kushtetues të KPK, pra të ndryshojmë datat e afatet sa herë kemi një dështim në rezultate, që të ndryshohen ligjet organike për emërimin e KLGJ e KLP në gjyqësor, apo për zbutjen e kriterëve të kandidimit, etj, mund të duken zgjidhje e sforcuar për momentin, por në thelb ato janë e mbeten devijim nga legjitimiteti dhe në këtë formë, edhe kërcënim për të sotmen dhe të ardhmen e saj.

7. **SPAK si zgjidhje apo si zgjedhje?** Çdo sondazh tregon se pritshmëritë ndaj SPAK janë maksimale, të gjithë që kanë një problem apo denoncim shkojnë në SPAK, apelojnë SPAK dhe presin nga SPAK. Ideja e reformës ishte që SPAK do merrej me dosjet VIP, me botën e krimin të organizuar dhe politikës, por aktet e tij ndërvarën nga BKH dhe nga struktura të tjera, përfshirë Policia e Shtetit, bashkëpunimi ndërkombëtar, shërbimet sekrete, etj. Që SPAK të ketë sukses duhet të funksionojë mekanizmi mbështetës dhe që SPAK të përmbushë pritshmëritë duhet që prokurorët e tij të mbushin axhendat ditore me hetime serioze dhe profesionale dhe jo me konferenca shtypi, intervista, vizita protokollare apo konsultime me selitë e partive. Për të pasur drejtësi SPAK nuk duhet të jetë zgjidhja, por një prej zgjedhjeve. Reforma duhet të forcojë Gjykatën Administrative dhe të Apelit, si edhe të reformojë Policinë e Shtetit dhe organet e tjera ligjzbatuese.
8. **Koha për reformë shqiptare të drejtësisë?** Mbështetja e SHBA dhe BE është jetike për reformën, por një reformë afatgjatë, kapilare dhe revolucionare kërkon mbi të gjitha bazë të qëndrueshme dhe horizontale besimi, dhe kjo nuk mund të jetë e ndërvarur pa limit kohor nga diplomatë apo zyrtarë me mandate 3-4 vjeçare në Shqipëri. Reforma duhet të punojë të ndryshojë kurbë funksionimi për tu bërë reformë për qytetarët dhe me qytetarët; institucionet e drejtësisë duhet të jenë më llogaridhënëse përpara qytetarëve të vet dhe zëra konstruktivë në shoqërinë civile, botën akademike, median, etj, duhen dëgjuar me të njëjtin respekt si 5-6 rreshtat anglisht në rrjetet sociale. Diplomatët janë këtu për të na ndihmuar dhe po e bëjnë këtë, por në çdo rast ashtu si sukcesi, edhe përgjegjësia, kosto dhe çmimi i dështimit të mundshëm bie vetëm mbi qytetarët, shtetin dhe vendin tonë.
9. **Reforma nuk mund të dështojë?** Duke qenë investimi më i madh perëndimor në Tiranë në vitet e fundit, reforma në drejtësi, si model eksperimental, nuk mund të dështojë dhe me siguri, nuk do të lejohet të dështojë. Praktika si lista e zezë amerikane apo akte të tjera të

ngjashme nga vende të BE-së janë provë për këtë. Nëse pamundësohen ose vonohen ndryshimi pozitiv dhe rezultatet e drejtësisë së re, atëherë reforma mund të krijojë një koalicion informal partish dhe rrjetesh klienteliste kundër saj, duke tentuar ta bllokojnë, ta denigrojnë dhe kështu, ta pamundësojnë. Duke e kuptuar si duhet këtë mesazh, institucionet tona, sidomos partitë, parlamenti, qeveria dhe aktorët e tjerë të përfshirë, duhet të heqin dorë nga trajtimi i reformës si "gjë e huaj" dhe ta trajtojnë me seriozitetin më të madh, si sfidën tonë, nevojën tonë, prioritetin tonë, rrugëzgjdhjen tonë drejt një standardi më të lartë të shtetit të së drejtës.

10. Së fundi, **nevoja jetike për monitorimin e reformës**. Ka një paradoks: të gjithë flasin për reformën në drejtësi, të gjithë duket se dinë gjithçka për të, të gjithë duket se e monitorojnë atë, por në fakt, gjatë 4-5 viteve të fundit ka më shumë studime për vlerat shëndetësore të kafesë apo fituesit sesa mbi reformën në drejtësi. Ka fjalime, ka raporte, ka retorikë konsumi, ka debate, por nuk ka analiza të thelluara strukturore, raporte serioze bilanci, debat serioz juridik dhe as pjesëmarrje të grupeve të interesit në to (avokatë, noterë, gjyqtarë, prokurorë, etj). Reforma në drejtësi meriton vëmendje, monitorim, analizim, reflektim; rol më aktiv të fakulteteve të drejtësisë, përfshirje më të madhe të shoqërisë civile, pjesëmarrje më aktive të ekspertëve dhe analiza/raporte më profesionale nga vetë institucionet e drejtësisë.

Ekipi i monitorues

**Instituti i Studimeve Politike (ISP)**